




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE  
TË MINISTRISË SË FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE PËR  
VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

## PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

Opinionin dhe konkluzionin jepem vetëm për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, pa përfshirë Doganën e Kosovës dhe Administratën Tatimore të Kosovës, për të cilat kryejmë auditime të veçanta si dhe përgatim raporte individuale, përfshirë edhe opinionet e auditimit.

## Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKAsë, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për

Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

### **Baza për konkluzion**

- A1 Vonesat në pagesën e faturave në vlerë 119,929€ deri në 110 ditë pas afatit ligjor dhe mos raportim i tyre në raportet mujore në Thesar; dhe
- C1 Avanset e pambyllura në SIMFK nga vitet paraprake në vlerë 72,191€ (MFPT në vlerë 6,889€ dhe ish MPMS në vlerë 65,302€).

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

### **Çështje tjetër**

Bazuar në rregulloren nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, është bërë fuzionimi i dy ministrive (Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale) në një ministri, siç është Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Pas hyrjes në fuqi të ligjit të rishikimit të buxhetit nr. 08/L-016, në gusht 2021 dy ministritë janë fuzionuar edhe formalisht në një organizatë buxhetore.

### **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

### **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme;
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për

atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm;

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti; dhe
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKAsë, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat ishin efektive, ndërsa kontrollet mbi shpenzimet në përgjithësi kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar parregullsitë.

Mangësitë kryesisht janë vërejtur në menaxhimin e pasurisë, ku si rezultat i mungesës së regjistrave të saktë dhe të plotë kishte nënvlerësim të pasurive. Më tutje, vonesat në pagesën e faturave si dhe avanset e pambyllura nga vitet paraprake mbeten sfidë për tu adresuar plotësisht. Fushë tjetër me probleme të theksuara janë subvencionet - pagesat e skemave pensionale dhe sociale, ku vazhdojnë pagesat për përfituesit e ndihmave sociale dhe pensioneve për persona që janë punësuar si dhe pensione të paguara pas vdekjes. Po ashtu, për shkak të mos harmonizimit të legjislacionit për skemat pensionale, vazhdojnë pagesat ndaj përfituesve që gëzojnë më shumë se një pension.

Ky raport ka rezultuar me tetë (8) rekomandime, prej tyre dy rekomandime të reja, një pjesërisht i përsëritur dhe pesë (5) rekomandime të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A1 - Vonesë në pagesën e faturave dhe mos raportimi i tyre mujor në Thesar

#### Gjetja

Sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, neni 39, ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme të paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Më tutje, sipas rregullës financiare nr.02/2013 MF për raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore neni 5 pika 2 thekson se Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që në Ministrinë e Financave - Thesar të raportojnë obligimet e tyre të papaguara, përmes raporteve mujore. Ne identifikuam se:

- Fatura në vlerë 114,190€ për projektin “Ndërtimi i shtëpive për komunitetet”, ishte pranuar dhe protokoluuar me datë 15.07.2021 në arkivën e ish MPMS-së. Pagesa e kësaj fature ishte bërë më 06.12.2021 përkatësisht 110 ditë pas afatit të përcaktuar. Për më tepër, kjo faturë nuk ishte raportuar në raportet mujore të obligimeve të papaguara për muajt vijues; dhe
- Fatura në vlerë 5,739€, e kontratës “Furnizim me teknikë të bardhë”, ishte pranuar më datë 22.12.2020, ndërsa ishte paguar me datë 08.04.2021, apo 74 ditë pas afatit ligjor.

Vonesa në rastin e parë kishte ndodhur për shkak se pas protokollimit të faturës në arkivën e ish MPMS-së, nuk ishte dorëzuar në zyrën e financave për shkaqe të panjohura, ndërsa pas fuzionimit të dy ministrive, Zv. Sekretari i Përgjithshëm aktual është vënë në dijeni pas kontaktimit nga Operator Ekonomik, ku në bazë të dokumentacionit të pranimit është konstatuar se ka të bëjë me një obligim ligjor dhe më tutje ka iniciuar procedurën e pagesës më datë 17.11.2021. Ndërsa në rastin e dytë arsyeja e vonesës ishte mos kompletimi i dokumentacionit për pagesë.

#### Ndikimi

Kontrollet joefektive në pagesën e faturave brenda afatit dhe mos raportimi i faturave të papaguara, shpiejnë në rrezikun që këto pagesa të procedohen përmes përmbarrimit duke shkaktuar shpenzime shtesë ndaj ministrisë.

#### Rekomandimi A1

Ministri, duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve efektive në pranimin e faturave dhe procedimin e tyre për pagesë brenda afatit ligjor. Më tutje, çdo obligim i papaguar duhet të raportohet në mënyrë të rregullt në raportet mujore në Thesar, deri në kryerjen e pagesës.



## **Çështja C1 - Avanset e pambyllura në SIMFK nga vitet paraprake**

### **Gjetja**

Sipas UA nr. 2004/07 për udhëtime zyrtare, neni 8, avanset për udhëtime zyrtare duhet të mbyllen dhe shumat e pashpenzuara duhet të kthehen në llogarinë bankare brenda 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi zyrtar.

Avanset e pambyllura deri në fund të vitit 2021 në MFPT ishin 72,191€, prej të cilave 65,302€, kishin të bënin me ish-MPMS, ndërsa 6,889€ me ish-MF-në. Duhet theksuar se në prill të vitit 2022 MFPT kishte bërë mbylljen e plotë të avanseve të ish-MF-së. Përderisa, për avancet e pambyllura nga ish-MPMS nuk ishin marrë masa konkrete, të cilat sipas zyrtarëve përkatës, këto avance kryesisht ishin të stafit politik dhe kishin të bënin me mjetet e tërhequra me kredit kartelë.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos përgjegjësisë së personelit që i ka marrë këto mjete në arsyetimin apo kthimin e tyre.

### **Ndikimi**

Mos mbyllja e avanseve në SIMFK/regjistra kontabël, ka ndikuar që llogaritë e avanseve të vazhdojnë të mbesin të hapura (aktive) dhe të barten nga viti në vit.

### **Rekomandimi C1**

Ministri, duhet të siguroj përmes menaxherit të financave vazhdimin e ndërmarrjes së veprimeve konkrete për mbylljen e tërësishme të avanseve të hapura edhe për pjesën e ish MPMS-së.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.2.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje është 21,885,204€, prej tyre ishin shpenzuar 21,880,737€. Numri i të punësuarve në fund të vitit ishte 2,496.

#### Çështja A2 - Mungesa e akt-emërimit

**Gjetja** Sipas nenit 32 të ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik përcaktohet që - Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil është marrëdhënie juridike ndërmjet Shtetit dhe nëpunësit civil, dhe është marrëdhënie juridike e së drejtës administrative e cila themelohet me aktin e emërimit i cili është i përhershëm (me afat të pacaktuar).

Gjatë vitit 2021 Ministria ka paguar punonjës në pozitën “Drejtor i Përgjithshëm në Zyrën për Çështjet e Trashëgimisë së TMK-së”, në mungesë të akt emërim valid, pasi që akt emërimi i të njëjtit kishte skaduar me 31.12.2020. Punonjësi kishte vazhduar vijueshmërinë në mënyrë të rregullt në punë, dëshmuar me raportet e vijueshmërisë.

Sipas menaxherit të burimeve njerëzore shkak i kësaj gjendje ishte fuzionimi i MPMS në MFPT dhe në mungesë të informatës lidhur me këtë rast kjo çështje ka mbetur e patrajtuar nga menaxhmenti i MFPT-së.

**Ndikimi** Paguesa e të punësuarit dhe vijueshmëria në punë në mungesë të aktemërimit (kontratës) valide, është në kundërshtim me dispozitat ligjore, duke rrezikuar në pagesa të parregullta.

**Rekomandimi A2** Ministri duhet të sigurojë zgjidhjen e rastit për pozitën e lartëcekur sipas kërkesave ligjore, dhe të siguroj se çdo pagesë bëhet në përputhje me aktemërim (kontratë) valide.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2.2 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 633,192,356€, prej tyre ishin shpenzuar 619,961,989€. Kjo kategori përbën 95% të buxhetit të ministrisë dhe shpenzimet kanë të bëjnë kryesisht me skemat pensionale dhe sociale, si dhe subvencione të ndara në kuadër të projektit “Pakoja e Ringjalljes Ekonomike”. Kemi zhvilluar procedura analitike substanciale krahasuese për skemat pensionale dhe sociale, ndërsa për pjesën tjetër të subvencioneve kemi kryer teste substanciale dhe të pajtueshmërisë.

Me rastin e ekzaminimit të pagesave të skemave pensionale dhe atyre sociale, ne kemi identifikuar një shumë prej 2,157,167€ të paguara jashtë kriterëve të përcaktuara ligjore apo pa një bazë të qartë ligjore.

### Çështja B1 - Përfituesit e pensioneve dhe ndihmave sociale nga personat e punësuar dhe pensionet e paguara pas vdekjes

**Gjetja** Sipas nenit 10.4.2 të ligjit Nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga Shteti, pensionet e parakohshme “Trepça” ndërpriten së paguari, nëse personi punësohet apo vetëpunësohet. Më tutje, sipas nenit 16.4 të ligjit Nr.04/L-261 për Veteranët e UÇK-së - Veteranët e UÇK-së të cilët janë të punësuar në sektorin publik dhe privat nuk kanë të drejtë të përfitimit të pensionit, si dhe sipas nenit 4.4 të ligjit Nr.04/L-096 për skemën e ndihmës sociale ndalon të drejtën për ndihmë sociale për persona të punësuar.

Sipas Ligjeve përkatëse të skemave pensionale dhe rregullave të aplikueshme, pensionet duhet të ndalen pas vdekjes së përfituesve.

a) **Përfitimi i pensioneve nga personat e punësuar** - Nga krahasimi i të dhënave të MFPT-së për skemat pensionale dhe ndihmat sociale me të dhënat e ATK-së, kemi vërejtur se ekzistojnë raste të përfitimit të pensioneve apo ndihmave sociale nga persona të cilët punojnë apo realizojnë të ardhura personale. Vlera e gabimit financiar për vitin 2021 ishte 405,313€.

**Tabela 1. Përfitimet e pensioneve nga personat e punësuar (në €)**

Nr	Lloji i Skemës	Numri i pagesave	Gabimi Financiar (€)
1	Ndihma Sociale	1,129	191,548
2	Pensionet Trepca	83	10,758
3	DFDIL Veteran	1,111	203,007
<b>Gjithsej</b>		<b>2,323</b>	<b>405,313</b>

Megjithëse ministria në baza mujore bën krahasimin e të dhënave të shfrytëzuesve të ndihmës sociale me të dhënat e tatimpaguesve në ATK, për shkak të deklarimit të vonuar të punëtorëve nga punëdhënësit në ATK,

në mënyrë retroaktive, proces i cili është jashtë kontrollit të ministrisë, kanë ndodhur pagesat për përfituesit që janë të punësuar. Sipas informatave nga ministria, 122 familje kishin kthyer pagesat e ndihmës sociale, ndërsa për katër raste është inicuar procedurë gjyqësore për kthimin e pagesës.

b) **Pensionet e paguara pas vdekjes** - Nga krahasimi i të dhënave/regjistrave ndërmjet MFPT dhe Agjencisë së Regjistrimit Civil kemi gjetur se gjatë vitit 2021 janë realizuar gjithsej 3,314 pagesa, në vlerë totale 465,121€ për pensione pas vdekjes së përfituesve.

**Tabela 2. Pensionet e paguara pas vdekjes (në Euro)**

Lloji i pensionit (Skemes Pensionale)	Pagesat për përfituesit që kanë vdekur para vitit 2021		Pagesat për përfituesit që kanë vdekur gjatë vitit 2021		Gjithsej pagesat pas vdekjes së përfituesve	
	Numri i pagesave	Shuma (€)	Numri i pagesave	Shuma (€)	Numri i pagesave	Shuma (€)
Skema e të verberve	16	4,100	31	7,975	47	12,075
Pensionet Bazë	770	88,170	1,336	146,940	2,106	235,110
Pensionet Kontributive	277	56,746	539	106,503	816	163,249
Pensionet për Persona me Aftësi të Kufizuar (PPAK)	40	5,055	152	19,505	192	24,560
Pensionet e Parakohshme të Trepçes	4	504	5	630	9	1,134
Pensionet e TMK-se			3	716	3	716
DFDIL Veteran	53	8,598	58	9,554	111	18,152
Pernsionet për Paraplegjiket dhe Tetraplegjiket (PPTP)	11	4,125	19	6,000	30	10,125
<b>Totali</b>	<b>1,171</b>	<b>167,298</b>	<b>2,143</b>	<b>297,823</b>	<b>3,314</b>	<b>465,121</b>

Pagesat pas vdekjes së përfituesve, kanë ndodhur si rezultat i ndërprerjes së lajmërimit të pensionistëve për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia, që nga muaji mars 2020, ku si rezultat, vdekjet e përfituesve nuk ishin regjistruar me kohë në ARC, dhe ministria nuk ishte e informuar për rastet.

**Ndikimi** Përfitimi i pensioneve nga personat e punësuar dhe mbetja e personave të vdekur në listat e pagesave shkaktojnë pagesa të parregullta, duke dëmtuar kështu buxhetin e Ministrisë.

**Rekomandimi B1** Ministri duhet të analizojë në hollësi çështjen e pagesave më sipër dhe të shqyrtoj mundësitë për kthimin e tyre nga shfrytëzuesit në llogarinë e buxhetit. Gjithashtu duhet të siguroj forcimin e kontrolleve të brendshme përmes komunikimit në kohë reale në mes të regjistrave me regjistrin civil, të bëj krahasime sistematike të listave të përfituesve me informatat e marra nga ATK dhe regjistrin civil, si dhe të krijoj një komunikim më efektiv ndërmjet data bazave të skemave pensionale.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja B2 - Përfitimi i më shumë se një pensioni nga skemat pensionale

**Gjetja** Ligji Nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, rregullon pensionet bazë të moshës, pensionet kontribut pagues të moshës, pensionet e aftësisë së kufizuar, pensionet e parakohshme, pensionet familjare dhe pensionet invalidore të punës. Sipas nenit 16 të këtij ligji, personat të cilët janë përfitues të cilitdo pension të skemave të përcaktuara me këtë ligj në asnjë rrethanë, nuk mund të jenë përfitues të ndonjë pensioni tjetër nga skemat e veçanta pensionale të cilat menaxhohen nga shteti.

Sipas ligjit Nr. 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L054 për Statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre - neni 5.1.4 përfituesit e pensioneve familjare, invalidor personal dhe invalidor familjar nuk mund të jenë shfrytëzues të asnjë pensioni nga skemat e tjera pensionale të aplikueshme në Kosovë, përveç nëse ndryshe është e përcaktuar me ligj.

Sipas ligjit Nr.04/L-261 për Veteranët e UÇK-së neni 16 pika 2, Veteranët e UÇK-së nuk mund të jenë shfrytëzues të asnjë pensioni nga skemat e tjera pensionale të financuara nga shteti. Nëse veterani është shfrytëzues i ndonjë skeme pensionale të financuar nga shteti duhet të përcaktohet se cilin pension do ta marrë.

Sipas ligjit Nr. 04/L-084 për pensionet e Pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, neni 5.3 përfituesit që kanë të drejtë në pensionin e FSK-së duhet të zgjedhin njërin nga përfitimet: pensionin që u takon me këtë ligj, apo përfitimet tjera që parashihen me ligjet tjera në fuqi.

Për këtë qëllim është e rëndësishme të theksohet se Ligji nr.03/L-100 për Pensionet e pjesëtarëve të TMK-së nuk ka ndonjë dispozitë ligjore e cila në

mënyrë të qartë ua njeh të drejtën e vazhdimet të marrjes së pensionit të TMK-së nëse personat e njejtë gëzojnë edhe ndonjë pension tjetër nga skema pensionale.

Bazuar në krahasimin e të dhënave të Ministrisë për skemat pensionale dhe sociale kemi identifikuar se Ministria kishte kryer pagesa në vlerë 1,286,733€ për përfitues të cilët gëzojnë më shumë se një pension. Rastet më të shpeshta të përfitimit të më shumë se një pensioni nga skemat pensionale, janë përfituesit që i takojnë kategorisë së TMK-së dhe FSK-së, të cilat pagesa Ministria i kishte kryer edhe vitin e kaluar bazuar në vendimin e ish Kryeministrit nr. 12/82 të datës 28.12.2018. Me këtë vendim ishte aprovuar vazhdimi i pagesave të pensioneve të dyfishta për FSK dhe ish-pjesëtarët e TMK-së deri në interpretimin përfundimtar të ligjeve për skemat pensionale. Në një krahasim me tri vitet e fundit, vërehet një rritje e lehtë e shumës së këtyre pagesave vit pas viti.

**Tabela 3. Përfituesit e më shumë se një pensioni nga skemat pensionale**

<b>Nr</b>	<b>Lloji i Skemës</b>	<b>Numri i pagesave</b>	<b>Gabimi Financiar në €</b>
1	Pensionet e Forcës Së Sigurisë së Kosovës FSK dhe DFDIL Familjar	1,399	352,825
2	Pensionet e Forcës Së Sigurisë së Kosovës FSK dhe DFDIL Veteran	-	-
3	Pensionet e Trupave të Mbrojtjes së Kosoves TMK dhe DFDIL Familjar	4,302	928,032
4	Pensionet e Trupave të Mbrojtjes së Kosoves TMK dhe DFDIL Veteran	12	1,428
5	Pensionet Bazë (PB) dhe DFDIL Familjar	19	2,329
6	Pensionet Bazë (PB) dhe DFDIL Veteran	11	1,284
7	Pensionet Kontributive (PK) dhe DFDIL Familjar	1	225
8	Pensionet Kontributive (PK) dhe DFDIL Veteran	2	340
9	Pensionet për Persona me Aftësi të Kufizuar (PPAK) dhe DFDIL Familjar	-	-
10	Pensionet për Persona me Aftësi të Kufizuar (PPAK) dhe DFDIL Veteran	2	270
11	DFDIL Familjar dhe PIP	-	-
12	Trepça dhe DFDIL Veteran	-	-
13	KV dhe DFDIL Familjar	-	-
<b>Gjithsej</b>		<b>5,748</b>	<b>1,286,733</b>

Shkak për këtë gjendje ishte mungesa e interpretimit përfundimtar të ligjeve për skemat pensionale, pandemia dhe fuzionimi i Ministrisë.

**Ndikimi** Pagesat e pensioneve të dyfishta për personat e njëjtë pa një interpretim të bazës ligjore nga organet përgjegjëse mund të dëmtojnë buxhetin e Ministrisë.

**Rekomandimi B2** Ministri duhet të inicojë procedurat për të bërë interpretim dhe vlerësim të pajtueshmërisë së dispozitave ligjore në lidhje me pensionet e dyfishta.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 31,824,157€, pasurive jokapitale është 1,382,502€, si dhe e stoqeve 435,453€.

### Çështja B3 - Dobësi në regjistrat kontabël të pasurive kapitale dhe jokapitale

#### Gjetja

Sipas nenit 6, pikës 3 të Rregullores MF - Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin “e-pasuria”. Kurse neni 5 i të njëjtës rregullore e përcakton klasifikimin që duhet aplikuar për regjistrimin e pasurive.

Bazuar në nenin 22 të rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare, pasuritë duhet të vlerësohen duke marrë parasysh zhvlerësimin që është grumbulluar nga momenti i blerjes së pasurisë dhe se zhvlerësimi llogaritet në baza mujore. Më tutje, neni 11.3 i të njëjtës rregullore, thekson se pas përfundimit të procesit të investimit, pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim, ndërsa nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi.

Nga testimet dhe analizat e regjistrat të pasurive kemi identifikuar se pasuritë e Ministrisë në PFV ishin të nënvlerësuara për 213,195€. Informatat detaje mund të shihen si në vijim:

- Autoambulanca e blerë në vlerë 39,500€ (projekt nga ish MPMS) nuk ishte regjistruar në SIMFK dhe si rezultat nuk ishte raportuar as në PFV;
- Pasuritë kapitale në vlerë 17,985€ (i takonin ish MPMS), nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive kapitale në SIMFK, dhe rrjedhimisht nuk ishin raportuar në PFV;
- Pasuritë jokapitale në vlerë 180,290€ të regjistruara në e-pasuri (të cilat i takonin ish MPMS), nuk ishin raportuar në PFV për vitin 2021. Kjo për shkak se zyrtari i pasurisë e ka gjeneruar raportin vetëm për vitin 2021 (duke mos e përfshirë vlerën e plotë të e-Pasurive) dhe të njëjtën e ka raportuar te financat;
- Pasuritë jo kapitale në vlerë 11,134€ nuk ishin regjistruar në e-Pasuri. Prej tyre vlera e pasurive prej 5,650€ i takonin ish MPMS, kurse 5,484€ ishin të Njesisë së Inteligjences Financiare (NJIF) edhe pse ishin të evidentuara në e-pasurinë e depos. Ato nuk ishin regjistruar në e-Pasuri për shkak të problemeve teknike me mos funksionimin e sistemit;



- Pasuritë jokapitale të Agjencisë Qëndrore të Prokurimit në vlerë 6,239€, nuk ishin të regjistruara në e-pasuri, si dhe nuk ishin raportuar në PFV;
- Te blerjet e vitit 2021 të regjistruara në e-pasuri, në vlerë 100,930€, nuk ishte aplikuar zhvlerësimi. Si rezultat i kësaj pasuritë jokapitale ishin mbivlerësuar për 17,723€. Po ashtu, kjo nuk ishte shpalosur as në PFV;
- Në tri mostra të testuara me vlerë prej 70,686€, (projekte të ish MPMS) Ministria ende nuk kishte filluar aplikimin e zhvlerësimit përkundër se këto projekte kishin përfunduar dhe ishte bërë pranimi i tyre teknik<sup>[1]</sup>. Këto pagesa nuk u janë mveshur shpenzimeve tjera të projekteve për tu kapitalizuar, mirëpo ishin klasifikuar në regjistrat e pasurisë si investime në vijim. Mbivlerësimi i pasurive kapitale si rezultat i mos zhvlerësimit është 9,705€; dhe
- Tetë vetura me vlerë kontabël të mbetur 4900€ (prej të cilave gjashtë me vlerë 3100€, të shitura me ankand përmes Ministrisë së Administratës Publike (MAP) në vitin 2018, dhe dy me vlerë 1800 të dhuruara në institucione tjera), nuk ishin fshirë nga regjistrat e pasurisë, ndonëse më nuk ishin në pronësi të ministrisë. Poashtu, dy shtëpi në vlerë 9,625€, të ndërtuara për familjet në nevojë përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit me komunat përkatëse, ende figuronin në regjistrat e pasurisë ndërsa do të duhej që pronësia t'iu bartej komunave përkatëse. Si rezultat i mos azhurnimit të regjistrave, pasuria ishte mbivlerësuar për 14,525€.

Mangësitë në regjistrat e pasurive (të ish MPMS) dhe mbajtja e pasurive të finalizuara si investime në vijim janë si pasojë e mos angazhimit të duhur nga zyrtari i pasurive për t'i regjistruar ato dhe për t'i raportuar në vlerën e plotë dhe të saktë tek ZKF.

Ndërsa sa i përket mos funksionimit të e-pasurisë në NjIF dhe AQP, kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontratës për mirëmbajtjen e këtij sistemi nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Gjithashtu, mos raportimi i tyre në PFV vjen si rezultat i mos njohurisë nga ZKF-të përkatëse të njëjësive se duhet raportuar edhe vlera e pasurive që nuk është e regjistruar në e-pasuri.

## Ndikimi

Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë të pasurive dhe raportimi jo i duhur i tyre pamundëson një menaxhim dhe kontroll efektiv mbi pasuritë. Si rrjedhojë e këtyre mangësive kemi nën nënvlerësim të pasurive duke rezultuar edhe në paraqitjen jo të drejtë të informatave rreth pasurive në PFV.

**Rekomandimi B3** Ministri duhet të vendosë kontrolle efektive në menaxhimin dhe raportimin e pasurive në PFV dhe të siguroj përmes zyrtarëve përkatës se pasuritë evidentohen, klasifikohen dhe shpalosen duke i respektuar të gjitha procedurat e kërkuara me rregulloren e aplikueshme të pasurisë. Më tutje në rastet kur nuk aplikohet zhvlerësimi nga e-pasuria, kjo duhet të shpaloset në PFV.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B4 - Mos kryerja e procesit të inventarizimit të pasurisë të ish-MPMS-së**

**Gjetja** Sipas Rregullores nr.02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 19, thekson se raporti i inventarizimit duhet të përgatitet para përgatitjes së PFV-ve në mënyrë që komisioni i inventarizimit të ketë mundësinë e krahasimit të gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare. Poashtu, sipas nenit 19, pika 4.3, Komisioni për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare duhet të bëjë krahasimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.

MFPT, kishte kryer inventarizimin e pasurisë dhe krahasimin e gjendjes së inventarizuar me regjistrat e pasurive vetëm për pasurinë e ish-Ministrit të Financave, ndërsa sa i përket pasurisë së ish-MPMS-së, nuk ishte bërë inventarizimi i pasurisë dhe harmonizimi i regjistrave para përgatitjes së pasqyrave financiare. ZKA kishte formuar komisionin për inventarizimin e kësaj pasurie në shkurt të vitit 2022 dhe komisioni kishte hartuar raportin e inventarizimit në mars të këtij viti megjithatë harmonizimi i këtij raporti me regjistrat e pasurive nuk ishte bërë.

Mos kryerja e procesit të inventarizimit të pasurisë për ish -MPMS-në para përgatitjes së pasqyrave financiare kishte ndodhur për shkak të vështirësive në koordinimin moskordinimit të duhur në mes të dy ministrive si rezultat i fuzionimit të tyre.

**Ndikimi** Mos kryerja e inventarizimit të pasurisë (për ish- MPMS) dhe mos harmonizimi i regjistrave të pasurisë, ndikon në mos verifikimin e saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurive të Ministrit. Po ashtu, kjo rritë rrezikun që ndryshimet eventuale të konstatuara nga komisioni të mos reflektohen në regjistrat e pasurive të prezantuar në PFV.

**Rekomandimi B4** Ministri, duhet të siguroj se para përgatitjes së pasqyrave financiare të bëhet inventarizimi i gjithë pasurisë në kuadër të MFPT-së si dhe krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive në mënyrë që të bëhet prezantimi i saktë dhe i plotë i pasurive në PFV për vitin 2022.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Në kuadër të MFPT-së, aktualisht funksionojnë tri departamente të NjAB-së, prej të cilave: departamenti i NjAB në kuadër të Thesarit, departamenti i Administratës Qendrore, si dhe NjAB për ish MPMS-në. Ne kemi trajtuar raportet e auditimit dhe rekomandimet e dhëna nga tri departamentet. NjAB në ish MPMS kishte planifikuar 18 auditime, të cilat kishte arritur t'i përfundoj brenda vitit 2021, ku kishte dhënë gjithsej 74 rekomandime. Nga rekomandimet e dhëna 67 ishin të zbatuara, pesë (5) ishin në proces dhe dy (2) të pazbatuara. NjAB në kuadër të Thesarit kishte planifikuar katër (4) auditime dhe gjatë vitit 2021 i kishte përfunduar pesë (5) prej të cilave një auditim me kërkesë nga menaxhmenti. Nga gjithsej 15 rekomandime të dhëna pesë (5) ishin zbatuar dhe dhjetë (10) ishin në proces. Ndërkaq, NjAB në Administratën Qendrore, kishte përfunduar gjashtë (6) auditime nga tetë (8) sa i kishte planifikuar, ku kishte dhënë gjithsej 34 rekomandime. Prej rekomandimeve të dhëna, katër ishin zbatuar ndërsa tjerat ishin në proces të zbatimit.

### Çështja B5 - Mos funksionimi i Komitetit të Auditimit në ish MPMS dhe mos shqyrtimi i raporteve të ish MPMS-së nga Komiteti aktual në MFPT

**Gjetja** Bazuar në UA-MF 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në sektorin publik, neni 4, çdo subjekt i sektorit publik që ka të themeluar Njësinë e auditimit të brendshëm në nivel të organit kryesor sipas legjislacionit në fuqi, themelon Komitetin e Auditimit.

Komiteti i auditimit në ish MPMS nuk kishte funksionuar për vitin 2021, për shkak të shpërbërjes së tij, si rezultat i dorëheqjes së kryesuesit dhe largimit të njërit nga anëtarët. Pas fuzionimit të dy ministrive, Komiteti i Auditimit në MFPT ka vazhduar të mbajë takimet e komitetit, por në këto takime nuk ishin shqyrtuar raportet e ish MPMS-së.

Shkaku i mostrajtit të raporteve të NjAB (ish MPMS) nga ana e Komitetit i Auditimit në MFPT ishte procesi i fuzionimit të dy Ministrive dhe sfidat në procesin e ristrukturimit të brendshëm.

**Ndikimi** Mos funksionimi i Komitetit të Auditimit rezulton me mungesë të monitorimit të punës të NjAB për të ofruar mbështetje menaxhmentit në vendimmarrje dhe të sigurojë që rekomandimet e auditimit janë pranuar dhe zbatuar.

**Rekomandimi B5** Ministri duhet të ndërmerr masa dhe të siguroj se Komiteti i Auditimit funksionon në mënyrë të plotë duke ofruar mbështetje dhe shqyrtim të të gjitha raporteve të realizuara nga departamentet e NjAB në kuadër të Ministrisë.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>206,924,433</b>	<b>685,892,530</b>	<b>655,901,138</b>	<b>608,270,724</b>	<b>31,299,912</b>
Grante Qeveritare – Buxheti	185,924,433	674,108,928	654,946,981	557,477,679	29,222,562
Financimi përmes huamarrjes	0	1,320,449	743,969	28,340,111	0
Financimi përmes huamarrjes – klauzola e investimeve	21,000,000	10,000,000	0	21,410,000	0
Te hyrat nga AKP-ja	0	0	0	703,451	1,682,082
Donacionet e jashtme	0	463,152	210,188	339,484	395,268

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 478,968,097€. Kjo rritje është rezultat i fuzionimit të programeve të ish Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale si dhe Agjencionit të Statistikave të Kosovës në kuadër të MFPT-së, financimit nga huamarrja, donacioneve të jashtme, si dhe grantit qeveritar përmes vendimeve të Qeverisë për kursime, ndarje dhe harmonizime buxhetore.

Në vitin 2021, MFPT ka shpenzuar 96% të buxhetit final ose 655,901,138€. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>206,924,433</b>	<b>685,892,530</b>	<b>655,901,138</b>	<b>608,270,724</b>	<b>31,299,912</b>
Pagat dhe mëditjet	33,431,336	21,885,205	21,880,737	21,516,295	16,511,716
Mallrat dhe shërbimet	22,993,179	8,471,125	7,488,151	6,999,095	6,331,096
Komunalitë	660,467	500,210	460,137	461,210	287,194
Subvencionet dhe transferet	114,020,000	633,192,356	619,961,989	571,812,887	2,055,509
Investimet Kapitale	32,819,452	21,843,634	6,110,124	7,481,237	6,114,398
Rezervat	3,000,000	1	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:


- Realizimi i buxhetit final në kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve ishte 100%. Buxheti final ishte zvogëluar për 11,546,131€ në raport me atë fillestar. Ky zvogëlim ishte bërë fillimisht përmes rishikimit të buxhetit në vlerë 8,929,965€, dhe më tutje në vlerë 2,616,165€ si rezultat i vendimeve të Qeverisë për ndarjet buxhetore nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike;
- Realizimi i buxhetit final në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve ishte 88%. Buxheti final ishte zvogëluar për 14,522,054€. Kjo vinte si rezultat i zvogëlimit përmes rishikimit të buxhetit në vlerë 12,141,836€, dhe më pas vendimeve të Qeverisë për ndarje dhe kursime buxhetore në vlerë 2,380,218€;
- Realizimi i buxhetit final për Komunalitë ishte 92%. Buxheti final ishte zvogëluar për 160,257€. Buxheti fillimisht ishte rritur me rishikim të buxhetit për 169,485€, ndërsa më tutje ishte zvogëluar në vlerë 329,742€ përmes vendimeve të Qeverisë për ndarje dhe kursime buxhetore;
- Realizimi i buxhetit për subvencione dhe transfere ishte 98%. Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 519,172,356€. Buxheti fillimisht ishte rritur në vlerë 556,425,522€, përmes rishikimit të buxhetit, si rezultat i fuzionimit të programeve të ish MPMS-së brenda MFPT-së, rritjes nga granti qeveritar, financimit nga huamarrja në vlerë 1,300,000€ si dhe donacioneve në vlerë 17,424€, ndërsa më tutje ishte zvogëluar për vlerën prej 37,253,166€, si rezultat i vendimeve të Qeverisë për ndarjet buxhetore nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike; dhe
- Realizimi i buxhetit për investime kapitale ishte 28%. Buxheti për investime kapitale ishte zvogëluar për 10,974,818€. Ky zvogëlim ishte bërë fillimisht përmes rishikimit të buxhetit në vlerë 7,934,498€, dhe më tutje përmes vendimeve të Qeverisë për kursime buxhetore në vlerë 3,041,320€.

Ky realizim i ulët vjen si rezultat i mos realizimit të projekteve kapitale të planifikuara nga ish MPMS dhe ish MF. Arsytet e mos realizimit ishte, se MF ishte në proces të hartimit të planit të fizibilitetit për konsolidimin e TI-së dhe koordinimin e investimeve mes TI-së në MFPT, ATK, Doganë, Thesar dhe ASHI, ku përfshihet edhe plani i investimeve në TI.

Si rezultat i këtij procesi, menaxhmenti kishte mbajtur qëndrim të mos zbatohen projektet kapitale të TI-së deri të realizohet studimi i fizibilitetit dhe plani investiv. Ndërsa sa i përket ish MPMS-së, nga 18 projekte kapitale të buxhetuara, pesë prej tyre janë realizuar, pesë janë shkëputur si rezultat i mos kryerjes së punëve nga ana e kontraktorit, dhe në tetë prej tyre nuk ka pasur kërkesë për inicim nga njësia kërkuese.

Shpenzimet lidhur me menaxhimin e pandemisë në kuadër të MFPT-së ishin 107,853,215€. Nga Pakoja për Rimbëkëmbje Ekonomike, ishin shpenzuar 107,729,111€ në subvencione dhe transfere dhe 111,043€ në paga dhe shtesa. Ndërsa nga pakoja emergjente ishin shpenzuar 12,090€ në subvencione dhe transfere dhe 971€ në mallra dhe shërbime.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



### 3.1 Të Hyrat

MFPT përfshirë Doganën dhe ATK-në për vitin 2021 ka realizuar të hyra neto në vlerë 1,916,601,876€. Ndërsa vetëm MFPT me njësitë tjera ka realizuar 1,412,401€ (të hyrat e vitit aktual 1,127,375€ dhe të hyrat nga viti i kaluar prej 285,026€). Ato kanë të bëjnë me gjobat ndaj institucioneve financiare dhe gjoba tjera, si dhe të hyrat nga licencimi i aktiviteteve individuale dhe shërbimeve profesionale.

Çështjet që i përkasin të hyrave të grumbulluara nga DK dhe ATK nuk ishin pjesë e këtij auditimi. Ato janë trajtuar në raporte të veçanta të auditimit.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Agjencitë / Departamenti	Të hyrat bruto	Kthimet	Të hyrat neto 2021	Të hyrat neto 2020	Të hyrat neto 2019
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>1,975,513,777</b>	<b>-58,911,901</b>	<b>1,916,601,876</b>	<b>1,487,058,714</b>	<b>1,638,550,252</b>
Administrata tatimore e Kosovës	597,681,803	-56,069,995	541,611,808	435,695,779	460,562,066
Dogana e Kosovës	1,376,704,600	-2,841,906	1,373,862,694	1,050,869,892	1,177,799,214
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT	0	0	0	1,200	0
Administrata Thesari i Kosovës	35,000	0	35,000	67,590	63,000
INSPEKTORIATI I PUNËS	410,502	0	410,502	0	0
Njësia e Inteligjencës Financiare	610,000	0	610,000	330,000	47,577
ADMINISTRATA QENDRORE - MF	45,462	0	45,462	94,253	78,396
KËSHILLI I PËRGJITHSHËM I SHËRBIMEVE SOCIALE	4,991	0	4,991	0	0
SHËRBIMET E PUNËSIMIT	21,420	0	21,420	0	0

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2020 të MFPT ka rezultuar në gjashtë (6) rekomandime, ndërsa raporti i auditimit për ish MPMS-në ka rezultuar në tetë (8) rekomandime. Dy ish ministritë kanë përgatitur Planet e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojnë rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, në MFPT katër (4) rekomandime ishin zbatuar, një (1) në proces dhe një (1) nuk është i aplikueshëm më, ndërsa sa i përket rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit për ish MPMS-në, dy (2) rekomandime janë zbatuar, një (1) nuk është i aplikueshëm më, dhe pesë (5) prej tyre nuk janë adresuar ende.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak






Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministri duhet të marrë masa për forcimin e kontrolleve në mirëmbajtjen e regjistrit të pasurisë dhe të inicojë një analizë gjithëpërfshirëse të veturave në mënyrë që të sigurohet se të gjitha pasuritë e regjistruara ekzistojnë fizikisht dhe janë nën kontrollin e Ministrisë.	Janë ofruar dëshmitë për veturën që nuk ka mundur të ekzaminohet.	I zbatuar
2.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë se për të prezantuar pamje të drejtë të informatave të pasurive, regjistri i pasurisë të azhurnohet në baza të rregullta, duke i respektuar të gjitha procedurat e kërkuara me rregulloren e aplikueshme të pasurisë. Më tutje, duhet të siguroj formimin e një Komisioni profesional të vlerësimit të pasurive në mënyrë që të gjitha pasuritë e regjistruara të reflektojnë vlerën e saktë në regjistrin kontabël.	Nuk janë ndërmarrë veprime për të adresuar plotësisht këtë rekomandim, por që kjo çështje në këtë raport është përfshirë të çështja B1.	Nuk është i aplikueshëm më
3.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë se janë forcuar kontrollet në menaxhimin e pasurisë, në mënyrë që për tërë pasurinë të ketë dokumentacion mbështetës. Po ashtu, në bashkëpunim me MAP dhe MF duhet të sigurojnë që regjistri i pasurive të azhurnohet dhe pasuritë që nuk janë pronë e Ministrisë duhet të shlyhen sipas kërkesave të rregullores.	Nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar
4.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë kontrolle efektive në regjistrimin e pasurive dhe raportimin e tyre në PFV, në mënyrë që të krijohet regjistri i saktë dhe i plotë të pasurisë dhe raportimi i drejtë në PFV.	Menaxhmenti i ish MPMS-së kishte ndërmarrë veprime për regjistrimin e pasurive që nuk ishin regjistruar në vitin paraprak, megjithatë mangësi të njejta në mosregjistrimin e pasurive janë hasur.	Nuk është adresuar
5.	Baza për	Ministri duhet të sigurojë se janë	Menaxhmenti ka	I zbatuar

	konkluzion	vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë që proceset e menaxhimit të pasurisë janë transparente dhe bëhen në përputhje të plotë me rregullën për menaxhimin e pasurive, duke harmonizuar gjendjen e pasurive me gjendjen e dalë nga inventarizimi.	ndërmarrë veprime dhe për pjesën e MPFT-së është kryer inventarizimi me kohë dhe është bërë harmonizimi regjistrave me raportin e inventarizimit.	
6.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë që komisioni për inventarizimin e pasurisë të përfundoj punën e tij para përgatitjes së pasqyrave financiare, si dhe të bëjë barazimin e të dhënave si rezultat i inventarizimit me gjendjen e pasurive në regjistrat kontabël. Mungesat, tepricat, pasuritë e dëmtuara, duhet t'i prezantojë në raport dhe të njëjtin duhet ta aprovoj menaxhmenti në mënyrë që ndryshimet të reflektohen edhe në regjistrat kontabël.	Menaxhmenti nuk kishte bërë përpjekje në sigurimin e Kontrolleve efektive në fushën e pasurisë pasi që kemi hasur çështje të njejta.	Nuk është adresuar
7.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Ministri duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të bëhet ri destinimi i mjeteve sipas kërkesave ligjore) dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet në mënyrë strikte sipas kodeve ekonomike adekuate.	Menaxhmenti ka ndërmarrë të gjitha veprimet mbi klasifikimin e drejtë të shpenzimeve.	I zbatuar
8.	Të hyrat	Ministri duhet të siguroj se pas çdo mbyllje të periudhës mujore, zyrtarët përgjegjës bëjnë barazimin e të hyrave me Thesarin, të realizuara nga secili epartment në kuadër të MF-së.	Menaxhmenti ka ndërmarrë veprime dhe rekomandimi është zbatuar.	I zbatuar
9.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri duhet të vazhdojë bashkëpunimin e mëtejshëm me Thesarin, me qëllim të eliminimit total të këtyre avanseve të hapura, si dhe të siguroj në të ardhmen mos përsëritjen e situatave të njëjta.	Menaxhmenti kishte ndërmarrë masa dhe në muajin Prill të vitit 2022 janë mbyllur të gjitha avanset e hapura për pjesën e ish MF-së, ndërsa për pjesën e ish MPMS-së vazhdojnë të mbeten të	Pjesërisht i zbatuar

			hapura.	
10.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të analizojë në hollësi çështjen e pagesave më sipër si dhe ta konsultoj zyrën ligjore nëse ka bazë ligjore për kthimin e këtyre pagesave nga shfrytëzuesit në llogarinë e buxhetit. Gjithashtu duhet të siguroj forcimin e kontrolleve të brendshme përmes komunikimit në kohë reale në mes të regjistrave me regjistrin civil, të bëj krahasime sistematike të listave të përfituesve me informatat e marra nga ATK dhe regjistrit civil, si dhe të krijoj një komunikim më efektiv ndërmjet data bazave të skemave pensionale.	Menaxhmenti përkundër përpjekjeve nuk ka mundur t'i eliminoj pagesat e subvencioneve dhe transfereve për ata përfitues që janë të punësuar si dhe pas vdekjes. Shih çështjen B2	Nuk është adresuar
11.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të inicioj menjëherë procedurat për harmonizimin e legjislacionit për skemat pensionale duke shfrytëzuar mekanizmat ligjor te organet përkatëse të cilat janë të ngarkuara me përgjegjësi për të bërë interpretime dhe vlerësime të pajtueshmërisë së dispozitave ligjore.	Menaxhmenti nuk kishte marrë veprime lidhur me implementimin e këtij rekomandimi. Edhe këtë vit ka pagesa për pensione të dyfishta. Shih çështjen B3.	Nuk është adresuar
12.	Pasuritë	Ministri duhet të vazhdojë të bëjë kërkesë ndaj kompanisë përgjegjëse për sistemin e-pasuria dhe njëkohësisht të monitoroj nga afër funksionalizimin e këtij sistemi, në mënyrë që të sigurohet se pasuritë jo kapitale dhe stoqet regjistrohen dhe menaxhohen përmes këtij sistemi.	Nuk janë marrë masa, prapë e-pasuria nuk ka funksionuar në AQP.	Nuk është i aplikueshëm më
13.	Auditimi i Brendshëm	Ministri duhet të ndërmerr masa për sigurimin e Planeve të Veprimit nga të gjitha njësitë administrative që u adresohen rekomandimet, si dhe të siguroj një përkushtim maksimal në përmirësimin në fushat ku dobësitë janë identifikuar, dhe rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve.	Janë përgatitur planet e veprimit dhe rekomandimi është zbatuar.	I zbatuar
14.	Auditimi i Brendshëm	Ministri duhet të siguroj themelimin e Komitetit të Auditimit siç parashihet me Ligjin nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike dhe udhëzimin administrativ MF nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik.	Menaxhmenti nuk ka ndërmarrë veprime për themelimin e Komitetit të Auditimit as për vitin 2021.	Nuk është adresuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit




Erëmira Bytyqi - Pllana, Udhëheqëse e ekipit



Mujë Gashi, Anëtar i ekipit



Veton Misiri, Anëtar i ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -  
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

*Kabineti i Ministrat - Kabinet Ministra - Minister's Cabinet*

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raport");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit. (kjo pikë përshtatet nga entiteti)
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Hekuran Murati  
Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve  
Data: 26 maj 2021, Prishtinë.



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### *Forma e opinionit*

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

## Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

### Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.



## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> (a) Projekti ideor i Qendrës për Aftësim Profesional-Gjakovë me vlerë 38,818€; (b) Renovimi i kulmit Qendrës për Aftësim Profesional-Ferizaj me vlerë 26,156€ dhe (c) Projekti ideor ZKP-Ranillug” me vlerë 5,712€.
- <sup>5</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.